


PËRFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE TË NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

Miratohet vendimi për çmimet e shitjes së teksteve të botuara nga QBD-ja si dhe kategorive që përfitojnë falas kopje të teksteve




Këshilli i Ministrave miratoi vendimin Nr. 408, datë 20.5.2020 "Për Miratimin e Çmimeve të Shitjes së Teksteve të Botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën, "Klasikët Dygjuhësh" dhe "Fjalorë Dygjuhësh Për Fëmijë" dhe të Kategorive që Përfitojnë Falas Kopje të Teksteve". Sipas këtij vendimi përcaktohen çmimet e shitjes së teksteve të botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën, "Klasikët Dygjuhësh" e "Fjalorë Dygjuhësh Për Fëmijë", si dhe kategoritë që përfitojnë falas kopje të këtyre teksteve, të cilët janë nxënësit dhe mësuesit, sipas përcaktimeve në vendimin nr.443, datë 26.6.2019, "Për organizimin e procesit mësimor dhe përgjdhjen e arsimtarëve në diasporë". Tekstet e botuara nga QBD-ja kanë si qëllim ruajtjen dhe zhvillimin e mësimin të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në Diasporë.

Aplikacioni informues "Diaspora Shqiptare"



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

Qendra e Botimeve për Diasporën, mbledhje online me përfaqësuesit e mësuesve në Gjermani dhe Zvicër



Qendra e Botimeve për Diasporën në vijimësi të mbledhjeve të organizuara online me drejtuesit dhe përfaqësuesit e lidhjeve të mësuesve në diasporë, me qëllim marrjen e informacionit dhe zgjidhjes së problematikave të lindura nga situata e re e krijuar prej gjendjes së pandemisë globale, ka zhvilluar mbledhje me mësuesit e gjuhës shqipe në Gjermani, Zvicër dhe përfaqësues të QBD-së, nën drejtimin e znj. Mimoza Hysa. Palët diskutuan ruajtjen e komunikimit dhe zhvillimit të mbledhjeve online në të ardhmen si një ndihmesë për diskutimin dhe zgjidhjen e problematikave të krijuara. Mbledhjet do të vijojnë edhe me përfaqësuesit dhe drejtuesit e lidhjeve të mësuesve në vendet e tjera.



Aplikacioni gazeta "Diaspora Shqiptare"



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

Qendra e Botimeve për Diasporën publikon falas online, fjalorët dygjuhësh për fëmijë

Fjalorët dygjuhësh për fëmijë: shqip-anglisht; shqip-italisht; shqip-greqisht dhe shqip-ukrainisht, botuar rishtas nga Qendra e Botimeve për Diasporën vijnë në formatin e-book dhe janë të shkarkueshëm falas për të gjithë. Fjalorët dygjuhësh për fëmijë është konceptuar për fëmijë të moshës deri në 6 vjeç dhe shoqërohet me ilustrime të përzgjedhura me kujdes për t'i qartësuar dhe për t'i konkretizuar edhe më shumë fjalët duke i bërë ato edhe më të kuptueshme për fëmijët. Ky fjalorë synon t'u japë fëmijëve të Diasporës një lëndë të pasur për të përmirësuar njohuritë e tyre në gjuhën shqipe, por gjithashtu mund të jetë shumë i vlefshëm edhe në procesin e mësimdhënies.



"Raporto" problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

Revista "Katundi Ynë", artikull për Qendrën e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët



Lajmi i themelimit të Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA), është publikuar edhe në numrin e fundit të revistës Katundi Ynë, për t'u bërë i njohur në të gjitha komunat arbëreshe në Itali dhe më gjerë, kudo ku përhapet kjo media. Në këtë artikull është realizuar edhe një intervistë me Drejtoreshën Ekzekutive të QSPA, prof. as. dr. Diana Kastrati, që ka folur mbi planet afatshkurta dhe afatgjata të qendrës. Që prej 17 prillit të këtij viti, QSPA është vënë në funksionim të plotë dhe puna vazhdon e pandërprerë. Kastrati ka ndarë me publikun edhe entuziazmin me të cilin është pritur hapja e kësaj qendre nga studiuesit të shumtë arbëreshë dhe shqiptarë, të cilëta kanë komunikuar dëshirën e madhe për bashkëpunime.



KKD / Brikena Muharremi, takim virtual me studentët në Kosovë

Avokatja shqiptare në Angli dhe njëkohësisht anëtare e Këshillit Koordinues të Diasporës, Brikena Muharremi, zhvilloi një takim virtual me studentët e Drejtësisë dhe Shkencave Politike në Kosovë. Njëpërmjet një publikimi në rrjetin social "Twitter" ajo bën të ditur se ky takim kishte si qëllim diskutimin në lidhje me detyrat dhe rolin e juristëve në advokimin për ndryshim dhe zhvillim shoqëror. Muharremi, krahas karrierës së saj si avokate, është themeluese e Shoqatës së Avokatëve Shqiptaro-Britanikë, që synon promovimin e bashkëpunimit mes avokatëve në Angli, Kosovë dhe Shqipëri. Ajo gjithashtu kontribuon në komunitetin e diasporës në cilësinë e anëtares së Këshillit Koordinues të Diasporës. Falë meritave të saj profesionale ajo është nominuar për çmimin "Women in Law 2020", një çmim i Odës së Avokatëve të Anglisë për gratë e suksesshme në fushën e drejtësisë.

KKD / Lazim Destani në ndihmë të familjeve në Maqedoninë e Veriut



Anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës, Lazim Destani, u vjen në ndihmë familjeve në situatë të vështirë ekonomike nëpërmjet kompanisë së tij "Ecolog International" duke dhuruar kupona në zonën e Tetovës e komunat përreth. Këto kupona do t'i shërbejnë përfituesve për të tërhequr produkte ushqimore e të higjienës në marketet e përcaktuara, duke mbështetur kështu dhe produktet vëndase. Filantropi shqiptar nëpërmjet një postimi në rrjetin social "Facebook" u drejtohet bizneseve e sipërmarrësve në diasporë të kontribuojnë për bashkatdhetarët e tyre në nevojë.